



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 23.11.2016

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I  
HIDROCENTRALEVE BIGAS 1, BIGAS 2 DHE VELESHNJE, ME VENDNDODHJE NË  
PELLGJET UJËMBLEDHËS TË PËRRENJVE BIGAS DHE VELESHNJE, NË NJËSITË  
ADMINISTRATIVE POTOM, ÇEPAN, BASHKIA SKRAPAR”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Hidrocentraleve Bigas 1, Biga 2 dhe Veleshnjë, me vendndodhje në pellgjet ujëmbledhës të përrrenjve Bigas dhe Veleshnje, në Njësitë Administrative Potom, Çepan, Bashkia Skrapar”, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “HP Bigas dhe Veleshnje Energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Skrapar;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

